



Republika e Kosovës
Република Косово - Republic of Kosovo
Qeveria - Влада - Government
Ministria për Komunitete dhe Kthim / Министарство за заједнице и повратак /
Ministry of Communities and Return

Fushë Kosovë : 29.05 2023

**THIRRJE PUBLIKE PËR DY ANËTAR TË KOMISIONIT (EKSPERTA) PËR
VLERËSIMIN E PROJEKTIT TË OCD-ës PËR FINANCIM TË AKTIVITETEVE TË
SEKTORIT TË OJQ-ve QË KANË PËR QËLLIMË RRRITJEN NIVELIT TË
PUNËSIMIT TË ANËTARËVE TË KOMUNITETIT JOSHUMICË DHE
PËRMIRËSIMIN E KAPACITETEVE PËR TË PROMOVUAR MBROJTJEN E TË
DREJTAVE TË KOMUNITETEVE (Vazhdim)**

1. Hyrje

Ministria për Komunitete dhe Kthim ka publikuar një thirrje publike për dorëzimin e projekt-propozimeve nga organizatat e shoqërisë civile me qëllim të kontribuimit në punësim, angazhim në praktikë dhe organizimin e trajnimeve me theks të veçantë për gratë, të rinjtë, personat me aftësi të veçanta si dhe grupet tjera të marginalizuara brenda komuniteteve joshumicë që jetojnë në Kosovë, si dhe përmirësimin e kapaciteteve të organizatave joqeveritare për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe forcimin e partneritetit dhe bashkëpunimit të organizatave joqeveritare me akterët. Ministria për Komunitete dhe Kthim fton të gjitha organizatat e shoqërisë civile të regjistruara në Republikën e Kosovës si dhe ekspertët qytetarë të Republikës së Kosovës, programi i punës i të cilëve është i fokusuar në zhvillimin e aktiviteteve të lartpërmendura, të aplikojnë për pjesëmarrje në komisioni për vlerësimin e projekt-propozimeve të OCD-ve që aplikojnë për këtë thirrje për dorëzimin e projekt propozimeve.

2. Thirrje për dy anëtar

Si pjesë e thirrjes për projekt propozime, sipas nenit 8 (3.2) të Rregullores së Ministrisë së Financave - nr. 04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, MKK hap këtë thirrje publike për përzgjedhjen e dy përfaqësuesve nga grupi i ekspertëve të jashtëm, njëri prej të cilëve duhet të jetë përfaqësues i OJQ-së.

3. Detyrat e Komisionit të Vlerësimit

Detyrat e komisionit vlerësues përcaktohen me rreullore. Komisioni i vlerësimit ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- o Të vlerësojë aplikimet nga aspekti procedural në përputhje me rregulloren;
- o Të vendosë nëse kandidatët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe specifike të përcaktuara me rregullore për t'u kualifikuar për mbështetje financiare publike;
- o Të shqyrtojë dhe vlerësojë aplikimet/propozimet e aplikantëve të kualifikuar për mbështetje financiare në aspektin e përmbajtjes;
- o Të sigurojë që projektet/programet e përzgjedhura për mbështetje financiare të përmbushin të gjitha kriteret e thirrjes publike dhe të kontribuojnë në arritjen e prioritetëve dhe objektivave të thirrjes;
- o Të kërkojë nga aplikantët dokumentacionin e nevojshëm shtesë pas publikimit të listës paraprake të përfituesve dhe para nënshkrimit të kontratës;
- o Ti përzgjedh përfituesit e mbështetjes financiare sipas thirrjes publike.

4. Kualifikimet

Për të qenë anëtar i Komisionit të Vlerësimit, kandidatët duhet të kenë këto kualifikime:

- Të kenë kryer me sukses studimet universitare në fushën e shkencave shoqërore, juridike ose ekonomi dhe biznes;
- Të ketë së paku 2 vjet përvojë pune në fushat relevante në thirrjen për propozime;
- Të ketë përvojë në vlerësimin e programeve/projekteve, skemave të granteve ndërkombëtare apo publike;
- Të ketë përvojë ose ekspertizë në një ose më shumë fusha prioritare të përfshira nga ftesa, duke përfshirë punën me të rinjtë, promovimin e platformave online ose zhvillimin ekonomik ose të biznesit;
- Që të jenë fleksibël në aspektin e kohës për të marrë pjesë në mbledhjet e Komisionit Vlerësues me kërkesë të MKK-së gjatë muajit qershor 2023.

Rregulla të përgjithshme për plotësimin e kërkesave të kualifikimit: Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit nuk mund të emërohen politikisht. Çdo anëtar i Komisionit nënshkruan një deklaratë për paanshmëri dhe konfidencialitet në marrjen e vendimeve. Anëtarët e emëruar të Komisionit duhet të sigurojnë paraprakisht që pjesëmarrja e tyre në këtë komision të jetë në përputhje me ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit, duke nënshkruar një deklaratë ku thuhet se nuk ka konflikt interesi. Në rast të një konflikti interesi, anëtarët duhet të kërkojnë zëvendësimin e tyre nga menaxheri.

5. Dorëzimi i aplikacioneve

Ju lutemi dorëzoni CV-në ose rezymen tuaj, dëshmitë e kualifikimeve profesionale dhe referencat për përvojën e punës, jo më vonë se data 11 qershor 2023, në Arhiven e MKKsë. MKK-ja mund të kërkojë dokumentacion shtesë nga aplikanti nëse nuk është i plotë.